



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Primitur / Dërguar Prilbena / Pridato Received / Delivery	20.02	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstva Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	1934/2023		115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A.nr.10/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.10/2023 të datës 04.01.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë banimi: Rruga " \_\_\_\_\_ Komuna e Prishtinës, kundër Përgjigjes Nr.14-070/01-2727731/22 të datës 23.12.2022 të Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 20.02.2022, mori këtë:**

**V E N D I M**

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.10/2023 e datës 04.01.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_**
- II. Shfuqizohet Përgjigja Nr.14-070/01-2727731/22 e datës 23.12.2022 e Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës.**
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës, që ti bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë kompensimin e diferencës së pagës së ankuesit në vlerën e një (1) koeficientit nga shtatë (7) në tetë (8) në mënyrë retroaktive dhe atë nga data 16.10.2017 deri më datë 01.12.2022.**
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

## Arsyetim

Ankuesi \_\_\_\_\_ i cili sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komunën e Prishtinës, më datë 04.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër Prot:11/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes së datës 23.12.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komuna e Prishtinës me rastin e refuzimit të kërkesës së tij për kompensim material ka vepruar në kundërshtim me Vendimin e Këshillit A/02/411/2017 të datës 16.10.2017, Vendimit A/02/631/2017 të datës 04.12.2017 sqarimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme/Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe Aktvendimit A.nr.1876/17 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamentin për Çështje Administrative pasi që ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Prishtinës. Ndërsa me datë 30.01.2023 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 04.01.2023 me numër protokollit 11/2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; kërkesën e ankuesit të datës 20.12.2022; Akt emërimit e ankuesit të datës 05.09.2013 me shifër: 01-112-639; Akt emërimit e ankuesit të datës 01.02.2017 me shifër: 01 Nr.112-639; E-mailin e datës 16.11.2020 dërguar nga I.LI për ankuesin; Përgjigjen e datës 23.12.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Akt emërimit e ankuesit të datës 01.12.2022 me shifër: 01-12-381; Vendimin e datës 24.11.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Përgjigjen e Këshillit të datës 26.09.2019; Vendimin e Këshillit A02/411/2017 të datës 16.10.2017; Vendimin e Këshillit A02/207/2017 të datës 14.06.2017; Vendimin e Kryetarit të Këshillit i datës 15.09.2017 me numër:59/2017; Vendimin e Këshillit A/02/631/2017 të datës 04.12.2017; Aktvendimin A.nr.1876/16 i datës 09.07.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Raportin e Avokatit të Popullit i datës 03.09.2017 me numër:334/2017; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.01.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 30.01.2023; E-mailin e datës 04.03.2022 dërguar nga ankuesi për Kryetarin e Komunës së Prishtinës me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 27.04.2016 dërguar nga D.K për A.Z.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit \_\_\_\_\_ është *pjesërisht e bazuar*, sepse:

Nga shkresat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesit i cili ishte i punësuar në Komunën e Prishtinës sipas Akt emërimit të datës 05.09.2013 me shifër: 01-112-639 në pozitën "Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike" në kuadër të Drejtorisë së Infrastrukturës Lokal, të njëjtit Komuna e Prishtinës bazuar në Vendimin për Organizimin, Kompetencat,

Përgjegjësit dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës së Administratës Komunale të datës 19.01.2016, i ka bërë lëshimin e Akt Emërimit të datës 01.02.2017 duke ia ndryshuar titullin e vendit të punës në pozitën "Zyrtar ligjor 2" në Kabinetin e Kryetarit, të cilin ankuesi e ka nënshkruar me vërtetje më datë 13.03.2017. Ankuesi kundër këtij akt emërimi të ndryshuar, ka parashtruar ankesë me datë 19.07.2017 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.10.2017 ka nxjerr Vendim A/02/411/2017 me të cilin ka aprovuar ankesën e ankuesit duke e obliguar Kryetarin e Komunës që të bëjë plotësim ndryshimin e aktit të emërimit të ankuesit në pajtim me klasifikimin e vendeve sipas katalogut të punës në shërbimin civil.

Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit të Këshillit A 02/411/2017 kishte hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa Komuna e Prishtinës ne seancën e shqyrtimit kryesore ishte tërhequr nga padia meqenëse nuk kishte interes juridik në çështjen e theksuar administrative, dhe si rrjedhojë Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 09.07.2019 nxjerrë Aktvendimin A.nr.1876/16 përmes të cilit Pezullohet procedura në çështje e konfliktit administrativ sipas padisë së datës 06.11.2017 të paditurës Komuna e Prishtinës kundër Vendimit të Këshillit A/02/411/2017.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës Kolegji i Këshillit gjen se Kryetrari i Komunës së Prishtinës me qëllim të zbatimit të Vendimit të Këshillit A/02/411/2017 me datë 24.11.2022 nxjerrë Vendimin me numër: 14-035/1-256821/22, mbi bazën e të cilit ankuesit i lëshohet akti i ri i emërimit me datë 01.12.2022 dhe shifër AE.Nr.01-112-381 duke e konfirmuar të njëjtin në pozitën e punës Zyrtar i Lartë Ligjor-LI/050 dhe koeficient tetë (8) në kuadër të Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave pranë Komunës së Prishtinës. Tutje, ankuesi me datë 20.12.2022 parashtron kërkesë pranë Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për kompensim e dëmit material në mënyrë retroaktive në vlerën e një (1) koeficienti nga periudha kohore 2013 deri në vitin 2017 duke përfshirë trustin pensional dhe kamat prej 8%, ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datë 23.12.2022 i ka kthyer përgjigje negative ankuesit duke iu referuar Vendimit të Këshillit A/02/411/2017 të datës 16.10.2017 me arsyetimin se i njëjti nuk e ka parashikuar kompensimin retroaktiv, ndërsa ndryshimi në pagë u bë vetëm nga momenti i lëshimit të aktit të emërimit të datës 01.12.2022.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit iu është referuar pikës II të dispozitiv të vendimit të Këshillit A/02/411/2017 të datës 16.10.2017 në të cilin specifikohet se: "*Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë plotësim-ndryshimin e akt emërimit të ankuesit në pajtim me klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil, Rregulloren për Organizmin, Kompetencat, Përgjegjësit dhe Sistematizimin e vendeve të punës së Administratës Komunale të Komunës së Prishtinës me numër 01Nr.031-13761 të datës 19.01.2016, dhe Katalogun e Punës në Shërbimin Civil, si dhe duke marr për bazë kualifikimin, përvojën dhe përshkrimin e vendit të punës së ankuesit", dhe po ashtu sjellë në vëmendje faktin se ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës së datës 19.07.2017 në Këshill nuk e ka pasur pretendim çështjen e koeficientit apo pagesës në mënyrë retroaktive edhe pse sipas aktit të emërimit të datës 05.09.2013 i njëjti ka qenë duke u paguar me koeficient shtatë (7), ndërsa fakti që*

Këshilli ka vendosur me Vendimin A/02/411/2017 të datës 16.10.2017 në dispozitiv iu ka referuar Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, sipas të cilit përcaktohet se për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë .." është e përcaktuar grada tetë (8), nga rrjedh se për pozitën e tillë koeficienti i pagës duhet të jetë tetë (8), andaj sipas Vendimit të Këshillit A/02/411/2017 të datës 16.10.2017 Kryetari i Komunës së Prishtinës ka qenë i obliguar që ankuesit ti lëshojë akt emërimit sipas titullit të pozitës "Zyrtar i Lartë ..." sipas Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil që lënë të kuptohet që edhe kompensimi i pagës duhet t'i bëhet sipas koeficientit tetë (8) duke u mbështetur në nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/1-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, është përcaktuar që: "Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë".

Prandaj nga se u tha më lartë, mbi bazën e analizimit të shkresave të lëndës, konstatimit të gjendjes faktike, analizimit të dispozitave ligjore si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesi është pjesërisht e bazuar, nga rrjedh se Komuna e Prishtinës obligohet që ankuesit t'ia bëjë kompensimin e diferencës së pagës në vlerën e një (1) koeficientit nga shtatë (7) në tetë (8) në mënyrë retroaktive dhe atë nga data 16.10.2017 deri më datë 01.12.2022, ndërsa pretendimi i ankuesit që ndërlihet me kërkesën e tij të parashtruar me datë 20.12.2022 në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që kompensimi retroaktiv t'i llogaritet nga viti 2013 është i pabazuar ngase sipas Vendimit A/02/411/2017 të datës 16.10.2017 nuk është trajtuar çështja e koeficientit në kuptim retroaktiv pasi që ankuesi nuk e kishte pretendim, madje në appetitumin e ankesës së datës 19.07.2017 ankuesi kërkonte që Këshilli të aprovojë ankesën e tij si të bazuar, të shfuqizojë akt emërimit e datës 01.02.2017 ndërsa ankuesin ta kthejë në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë Ligjor", dhe si e tillë ankesa është aprovuar, ndërsa në këtë vendim Këshilli nuk e ka trajtuar çështjen e kompensimit në mënyrë retroaktive, nga rrjedh se pretendimi ankimore i ankuesit që t'i njihet e drejta në kompensim në mënyrë retroaktive nga viti 2013 e tutje duke iu referuar vendimmarrjes së Këshillit është i paqëndrueshëm sikurse kanë kaluar edhe të gjitha afatet e përcaktuara kohore të përcaktuara me ligjin e procedurës së përgjithshme administrative.

Kolegji i Këshillit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga se u tha më lartë, konstaton se Përgjigja Nr.14-070/01-2727731/22 e datës 23.12.2022 e Menaxherit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës është i akt paligjshëm administrativ në kuptim të nenin 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që nuk ka ariut të përcaktojë saktë bazën ligjore sipas së cilës ankuesit nuk i takon kompensim në mënyrë retroaktive dhe pse është i zbatueshëm në rastin konkret, akti si i tillë nuk i përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ sikurse arsyetimi i dhënë në përgjigjen e goditur me këtë ankesë është kundërthënës dhe si i tillë është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson fakti se përmes Aktvendimit A.nr.1876/16 të datës 09.07.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të cilit ankuesi i është referuar, nuk ka vendosur në mënyrë meritore, gjegjësisht përmes Aktvendimit A.nr.1876/16 gjykata respektive e ka pezulluar procedurën në çështjen e konfliktit të hapur ndaj Vendimit të Këshillit A/02/411/2017 të datës 16.10.2017 pasi që Komuna e Prishtinës ka hequr dorë nga kërkesëpadia, duke i hapur rrugë ekzekutimit të



vendimit të Këshillit A/02/411/2017, ndërsa sa i përket Vendimit të Këshillit A/02/631/2017 të datës 04.12.2017 përmes të njëjtit është përfunduar procedimi administrativ i filluar sipas ankesës së ankuesit të datës 06.10.2017 meqenëse Këshilli kishte trajtuar edhe çështjen e shkeljes së të drejtës në pagë përmes Vendimit A/02/411/2017 të datës 16.10.2017.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.10/2023

**Flakron GASHI**  
  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**  
  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së